

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 24 Prot.

Tiranë, më 13.012016

VENDIM Nr. 129, datë 22.12.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "**Për Trashëgiminë Kulturore**" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.15, të datës 22.12.2015, pasi shqyrtoi Relacionin e ndjekjes periodike ditore të punimeve të realizuara nga Shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" Sh.P.K., në kuadër të **projektit "Rrjeti i ujësjellësit në qytetin e Lezhës dhe në Balldren"** dhe mbikëqyrjes arkeologjike për të, realizuar nga ASHA në bashkëpunim me DRKK Shkodër,

VENDOSI:

- I. Të miratojë Relacionin e ndjekjes periodike ditore të punimeve të realizuara nga Shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" Sh.P.K., në kuadër të **projektit "Rrjeti i ujësjellësit në qytetin e Lezhës dhe në Balldren"** dhe mbikëqyrjes arkeologjike për të, realizuar nga ASHA në bashkëpunim me DRKK Shkodër, duke përcaktuar që, për strukturat e mureve të gjetura në lagjen "Skënderbeg" të qytetit të Lezhës, tubacioni i ujësjellësit të mos i prekë dhe dëmtojë ato, por të vendoset nën/ose mbi nivelin e përfundimit të strukturës së tyre.
- II. Të realizohet dokumentimi i plotë i gjurmëve të mureve të evidentuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETARI KKA

RUDINA ZOTO